V E N D I M
Nr.86, datë 18.2.1999

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT "KONSULENCË PËR PRIVATIZIMIN E SEKTORËVE STRATEGJIKË" DHE TË MARRËVESHJES SË GRANTIT ITALIAN, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE IDA-S, SI ADMINISTRATORE E KËTIJ GRANTI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" dhe të nenit 2 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes së grantit italian, në shumën prej 1 100 000 (një milionë e njëqind mijë) USD, ndërmjet IDA-s, si administratore e fondeve grant dhe Qeverisë së Shqipërisë për projektin "Konsulencë për privatizimin e sektorëve strategjikë".

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij projekti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko